



Zyra e Marrëdhënieve me Publikun, prane Ambasadës Amerikane në Tiranë, ka hapur thirrjen për aplikime për Programin Veror Transatlantik Benjamin Franklin 2021 për nxënësit e shkollave të mesme.

**Afati i aplikimit është data 12 shkurt 2021.**

Programi Veror Transatlantik Benjamin Franklin 2021 do të zgjasë 4 javë, Qershor 26 – Korrik 31, 2021 në Universitetin Purdue në West Lafayette, Indiana. Qëllimet e këtij instituti janë:

- të rrisë përkushtimin në bashkëpunimin transatlantik
- të nxisë marrëdhëniet e të rinjve me etni të ndryshme, mes Amerikës dhe Europës
- të promovojë marrëveshje dypalëshe mes Amerikës dhe Europës
- të zhvillojë një kuadër udhëheqësish të rinj të cilët do ti ndajnë njohuritë dhe aftësitë me bashkëmohatarët e tyre mes shembujve positive

Aplikimet duhet të dërgohen në këtë adresë e-maili [EducationandCultureTirana@america.gov](mailto:EducationandCultureTirana@america.gov)

Për më shumë informacion vizitoni faqen e internetit të Ambasadës së ShBA <https://al.usembassy.gov/education-culture/educational-exchange-programs>.

Të interesuarit mund të regjistrohen për të marrë pjesë në seancat [Information session application form](#) që do të organizojë Zyra e Marrëdhënieve me Publikun në datat:

28 janar 2021 @15:30

2 shkurt 2021 @13:00

8 shkurt 2021 @15:00

Për pyetje dhe më shumë informacion, mund të kontaktoni: [EducationandCultureTirana@america.gov](mailto:EducationandCultureTirana@america.gov).